



**GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Saranda Bogaj-Shermeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Drejtësisë-Departamenti i Prokurimit, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës N.T.P “L...”, me seli në Prishtinë, duke vendosur përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 01.09.2022 mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

Për gjykim në këtë çështje juridike është kompetente në pikëpamje lëndore Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me aktvendimin e saj është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në çështjen juridike kontestimore, sipas padisë me numër C.nr.51/2016.

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike ka ushtruar propozim për vendosjen e konfliktit të kompetencës pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, me të cilën e ka iniciuar konfliktin e kompetencës duke konsideruar se Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike, është kompetent në pikëpamje lëndore për vendosje në këtë çështje juridike.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerëson se kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, për arsye se objekt kontesti janë mos marrëveshjet afariste ndërmjet subjekteve, nga Kontrata për furnizim dhe mirëmbajtje të material elektrik, nxemje dhe betonim për institucionit e shërbimit korrektues të Kosovës, (Kontrata 15/2009 nr.21500-09-010-121), nga ku rezulton se paditësja ka lidhur kontratë me subjektin ekonomik-të paditurën N.T.P “L...”, të cilin e përfaqëson-drejtori, i cili e ka nënshkruar kontratën në fjalë dhe e njëjta është e vulosur. Pra nga shikimi në shkresat e lëndës rezulton se të dyja palët ndërgjyqese janë persona juridik, ku paditësja rezulton të jete person juridiko-publik, ndërsa e paditura person juridiko-privat e cila ka formën e organizimit të biznesit individual, andaj sipas nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale në mënyrë decisive përcaktohet se gjykatë kompetente për të gjykuar në

këto konteste është Gjykata Komerciale, e ku nën par.1.1, i kësaj dispozite ka përcaktuar se “Gjykata Komerciale është kompetente për te gjykuar dhe ka juridiksion ekskluzivisht ne kontestet ndërmjet shoqërive tregtar vendore dhe te huaja si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, ne lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre.”

Mbi këtë bazë Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë konstaton se gjykate kompetente për te vendosur ne këto çështje ne shkalle te pare është Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 25.1 të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.859/2022 dt.01.09.2022**

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Faton Bajrami, d.v